

PROCESVERBAL

**nga vazhdimi i parë i seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 24.03.2025**

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:/

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski shpjegoi se në seancë do të shqyrtohet Propozim-procesverbali nga seanca e 11-të, miratimi i të cilit është shtyrë për arsye teknike.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 19.03.2025, me tekstin e propozuar.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**